

Z. Arsen Sinamataj, Ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Drejtësisë si dhe Akademinë e Rendit.

Që prej vitit 2017, zotëron titullin “Avokat”, nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Më parë, në karrierën e tij të gjatë ka mbuluar detyra dhe funksione të tjera në administratën publike, kryesisht në Policinë e Shtetit për një periudhë 15 vjeçare.

Z. Sinamataj ka nisur punë në Policinë e Shtetit që prej vitit 2007 si Specialist i Hetimit të Krimin në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë deri më 2008. Në periudhën 2008-2020, Z. Sinamataj ka mbajtur pozicione drejtuese në strukturat e Policisë së Shtetit në rrethet, Tiranë, Gjirokastrë dhe Elbasan.

Marrëdhëniet e punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit i ka filluar në vitin 2021 si Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të KLSH-së dhe më pas si Drejtor.

Aktualisht është në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në vazhden e proceseve të kualifikimit të tij profesional, ka ndjekur vazhdimisht formate të ndryshme trajnimi si në institucion dhe jashtë vendit, duke arritur kualifikime dhe specializime për çështje dhe problematika ngushtësisht të lidhura me funksionin.

Z. Sinamataj ka njohuri të mira në gjuhën angleze dhe italiane.